



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 1108, datë 30.12.2015

PËR

TRANSFERIMIN, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TE BASHKITË, TË INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, TË PERSONELIT DHE TË ASETVE TË LUAJTSHME E TË PALUAJTSHME TË BORDEVE RAJONALE TË KULLIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", dhetë neneve 3, shkronja "dh", e 5, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (bordet e kullimit) në pronësi të bashkive, të:
 - a) infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, sipas tabelave 1 dhe 1/1, bashkëlidhur këtij vendimi;
 - b) asetëve të paluajtshme, nga bordet e kullimit të bashkitë në territorin e të cilave është vendndodhja e tyre, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi. Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave i vihen në dispozicion për përdorim falas nga 2 zyra të çdo ndërtese, si dhe një pjesë e truallit për parkimin e mjeteve motorike;
 - c) makinerive të rënda (ekskavatorë), sipas tabelës 3, bashkëlidhur këtij vendimi;
 - ç) hidrovorit të Porto-Romanos Bashkisë Durrës, së bashku me skemën përkatëse të kullimit, dhe hidrovorit të qytetit Vlorë Bashkisë Vlorë, së bashku me skemën përkatëse të kullimit, sipas tabelës 4, bashkëlidhur këtij vendimi.
 - d) pajisjeve dhe orendive të bordeve të kullimit, në përputhje me shkronjën "b", të kësaj pike.

2. Transferimi, sipas pikës 1, kryhet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi nën mbikëqyrjen e prefektit të qarkut përkatës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, bashkitë janë përgjegjëse për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe sigurinë e digave të rezervuarëve që përdoren për ujitje dhe që u janë transferuar bashkive.
4. Bashkitë bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën për planifikimin e nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit me strukturat rajonale të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që administrojnë infrastrukturën kryesore në këto sisteme.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale dhe bashkitë bëjnë përditësimin e inventarëve të infrastrukturës së përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij vendimi, dhe i propozojnë Ministrisë së Punëve të Brendshme ndryshimet në vendimin nr.1157, datë 25.11.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, dhe përfshirjen e tyre në listat përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore, që u transferohen në pronësi bashkive”.
6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale, prefektët e qarqeve dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

EDMOND PANARITI

MINISTRI I SHTETIT
PËR ÇËSHTJET VENDORE

BLENDAR ÇUÇI